

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit (Programi: Master i mësimdhënies në matematikë)
Titulli i lëndës:	Mësimdhënia dhe të nxënit e matematikës I
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (Sem I)
Numri i orëve në javë:	2+2 (4 orë)
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	E martë, 14.00-15.30 (Salla e informatikës)
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Eda Vula
Detajet kontaktuese:	eda.vula@uni-pr.edu ;
Përshkrimi i lëndës	Kursi fokusohet në shqyrtimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit të matematikës, analizën e aspekteve teorike dhe të praktikave të mësimdhënies. Temat që përmban kursi përfshijnë bazat themelore për zhvillimin e të kuptuarit në matematikë, teoritë e të nxënit në matematikë, planifikimin për zhvillimin e koncepteve themelore për numrat dhe veprimet me numra, të kuptuarit e gjeometrisë dhe matjeve, punën me të dhënat dhe zbatimin e procedurave matematikore në jetën e përditshme. Studentët do të bashkëpunojnë për të shqyrtuar probleme të ndryshme, do të analizojnë situata të ndryshme dhe do të përgatiten për të zbatuar mësimdhënien me nxënësin në qendër, të bazuar në parimet kryesore të Kornizës Kurrikulare dhe Kurrikulën bërthamë 2 dhe 3.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi parësor i kursit është zhvillimi i shkathtësive të nevojshme të studentëve për mësimdhënie të matematikës. Së dyti, shqyrtimi 'kritik' i çështjeve që lidhen me mësimdhënien dhe të nxënit e matematikës në përgjithësi ka për qëllim aftësimin e studentëve për zbatim të metodave bashkëkohore të mësimdhënies me nxënësin në qendër.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> shqyrtojnë parimet kryesore të KKK-së dhe Kurrikulën bërthamë 2 dhe 3 në fushën e matematikës;

	<ul style="list-style-type: none"> • shqyrtojnë teoritë e ndryshme për të nxënit, dhe metodat e ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit; • zbatojnë burimet e ndryshme mësimore, si: mjetet manipulative, kalkulatorët dhe programe softuerike për mësimdhënien e matematikës në shkollën e mesme të ultë dhe atë të lartë; • dizajnojnë aktivitete efektive për nxënësit e talentuar dhe atyre me vështirësi në të nxënë dhe të reflektojnë për kompetencat dhe rezultatet e pritshme të nxënësve; • planifikojnë mësimdhënien duke u bazuar në stilet e ndryshme të të nxënit, nevojat dhe nivelin e nxënësve; • vlerësojnë rëndësinë e zgjidhjes së problemeve në proceset e të nxënit dhe në integrimin e matematikës me fusha tjera kurrikulare dhe probleme të jetës së përditshme
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	3	2	6
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgaditja përfundimtare për provim	4	4	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	3	1	3
Totali			139

139: 25 ≈ 6 ECTS.

Metodologjia e mësimëdhënies:	<i>Ligjerata interaktive, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike/projekte.</i>												
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete:</p> <p>Detyrat në ushtrime 10%</p> <p>Testi 1 30%</p> <p>Projektet 20 %</p> <p>Testi përfundimtar 40 %</p> <p>Nota përfundimtare:</p> <table> <tr> <td>Pikët (%)</td> <td>Nota</td> </tr> <tr> <td>92-100</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>82- 90</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>70 -80</td> <td>8</td> </tr> <tr> <td>60-69</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>50-59</td> <td>6</td> </tr> </table>	Pikët (%)	Nota	92-100	10	82- 90	9	70 -80	8	60-69	7	50-59	6
Pikët (%)	Nota												
92-100	10												
82- 90	9												
70 -80	8												
60-69	7												
50-59	6												
Literatura													
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> Groth, E. Randall (2013). Teaching Mathematics in Grades 6-12. Developing Research-Based Instructional Practices. Sage Publicatio, Inc. Martin, G., Strutchens, M., & Elliot, P. (2007). The learning of Mathematics. NCTM. Chambers, P. (2008). Teaching Mathematics: Developing as a reflective secondary teachers. SAGE Publications, Inc. 												
Literatura shtesë:	<i>KKK. KB2 dhe KB3 MASHT; Shënim: Si literaurë shtesë do të përdoren edhe punimet shkencore dhe profesionale për mësimdhënien e matematikës dhe burime tjera të nevojshme.</i>												
Plani i dizajnuar i mësimimit:													
Java	Ligjerata që do të zhvillohet												
<i>Java e parë:</i>	Paraqitja e kursit. Qëllimet dhe detyrat												
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në mësimdhënien dhe të nxënit e matematikës												
<i>Java e tretë:</i>	Mësimi i matematikës i bazuar në kompetenca (KKK dhe fusha kurrikulare e matematikës)												
<i>Java e katërt:</i>	Teoritë e të nxënit - Fusha kognitive												
<i>Java e pestë:</i>	Planifikimi për mësimdhënie të matematikës												
<i>Java e gjashtë:</i>	Strategjitë e mësimdhënies së matematikës												
<i>Java e shtatë:</i>	Mësimdhënia përmes zgjidhjes së problemeve												
<i>Java e tetë:</i>	Problemet me kontekst nga jeta reale												

Java e nëntë:	Testi 1
Java e dhjetë:	Nivelet e të menduarit dhe arsyetimet në matematikë
Java e njëmbëdhjetë:	Shfrytëzimi i manipulativeve, modelimeve dhe teknologjisë në orët e matematikës
Java e dymbëdhjetë:	Vlerësimi formativ dhe përmbledhës në matematikë
Java e trembëdhjetë:	Integrimi i matematikës me fushat tjera kurrikulare
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Çdo student duhet të:

- Vijnë me rregull ligjëratat;
- Lexojë literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për të gjitha aktivitetet tjera;
- Përgatitë dhe dorëzojë të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonesë do të ndëshkohet me pikë të humbura;
- Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për shkrimin e tezës së Masterit)
- Nuk lejohet kopjimi dhe gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye;
- Në provimin përfundimtar kanë të drejt të paraqiten vetëm studentët që kanë marrë pjesë në ligjëratat dhe ushtrime dhe që kanë kryer detyrat gjatë kursit;
- Studentët kanë të drejtë të hyjnë në provimin përfundimtar më së shumti tri herë (Neni 115 i Statutit të UP-së).